



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. _____ Prot.
2019

Elbasan, më ____ . ____ .

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISE SË PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

NJOFTIMI I FITUESIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Për: **“AlbaScan” sh.p.k me adresë:** Rruga Barrikada, Hyrja 1, përballë gjimnazit “Sami Frashëri”, Tiranë

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e Hapur”**.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-01775-12-26-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje dhe vendosje pajisje sigurie elektronike për rritjen e sigurisë publike”**, me fond limit **14.797.000** (katërmëdhjetëmilion e shtatëqind e nëntë dhjetë e shtatë mijë) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2019”, me afat për lëvrinim dhe vendosjen e mallit 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “AlbaScan” sh.p.k me Nipt: L 71416010 E

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **14.700.000** (katërmëdhjetëmilion e shtatëqindmijë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **17.640.000** (shtatëmbëdhjetëmilion e gjashtëqind e dyzetmijë) **lekë** (me tvsh).

2. “Elektrosek” sh.p.k me Nipt: L 12122013 A

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **14.777.777** (katërbëdhjetëmilion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **17.733.332,24** (shtatëmbëdhjetëmilion e shtatëqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e dy presje njëzet e katër) **lekë** (me tvsh).

3. “AL - COMM” sh.p.k. me Nipt: L 21931007 A

Ky operator nuk ka paraqitur oferte.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Elektrosek” sh.p.k me Nipt: L 12122013 A

2. “AL - COMM” sh.p.k. me Nipt: L 21931007 A

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Ofertuesi “Elektrosek” sh.p.k, skualifikohet për arsye se:

1. Nuk ka paraqitur asnjë dokument në përmbushje të kriterëve të përcaktuara tek Kriteret e Veçanta - Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar pikat 2.2.a) dhe 2.2.b), e konkretisht vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja e tre viteve të fundit financiare nga data e realizimit të tenderit të jetë jo me e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet dhe kopjen e çertifikuar të bilancit për vitin e fundit ushtrimor të mbyllur nga subjekti nisur nga data e zhvillimit të prokurimit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse.

2. Nuk ka paraqitur asnjë dokument në përmbushje të kriterit të përcaktuar tek Kriteret e Veçanta - Kapaciteti Teknik pika 2.3.1, e konkretisht kontrata për furnizime të ngjashme ose fatura tatimore shitje, për të provuar përvojën e mëparshme.

3. Nuk ka paraqitur asnjë dokument në përmbushje të kriterëve të përcaktuara tek Kriteret e Veçanta - Kapaciteti Teknik pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, si dhe 2.3.7 e konkretisht çertifikatë autorizimi nga prodhuesi për pajisjen që do ofertojë për shitje, instalim, mirëmbajtje, deklaratë ku të marrë përsipër trajnimin e stafit të sigurisë për operimin e pajisjes, deklaratë ku të marrë përsipër mirëmbajtjen e të gjitha paisjeve si dhe kalibrimin e Sistemit X-ray sipas udhëzimeve të prodhuesit për të paktën 1 vit nga momenti i vënies në punë, një vërtetim ose letër angazhimi nga prodhuesi i pajisjes “AUAV (Anti Unmanned Aerial Vehicle)” ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit, se montimi, konfigurimi dhe dorëzimi do të bëhet nga inxhinierë të kompanisë prodhuese ose inxhinierë të çertifikuar nga kompania prodhuese, për shkak të sensitivitetit të lartë të pajisjes dhe natyrës së punës, si dhe çertifikatë ISO 9001:2015 për "Menaxhimin e cilësisë" për objektin e prokurimit ose ISO

9001:2008 (të vlefshme).

Ofertuesi “AL - COMM” sh.p.k, skualifikohet për arsye se nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, si dhe dokumentacion ligjor, ekonomiko-financiar dhe teknik në përmbushje të kriterëve të DST-së.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“AlbaScan” Sh.p.k me adresë:** Rruga Barrikada, Hyrja 1, përballë gjimnazit “Sami Frashëri”, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **14.700.000** (katërmëdhjetëmilion e shtatëqindmijë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor do të anullojë procedurën, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 05.02.2019

Ankesa nuk ka patur.

TITULLARI I AUTORITETIT

KONTRAKTOR

PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ

ZV.KRYETARI

Klaudia Krasnika